

UDHËTIM NË KINË me ELITE TRAVEL AGENCY

Dita 1 : Tiranë – Shanghai

Takimi me guidën rreth orës 12:00 në aeroport. Nisja nga Tirana në orën 14:20. Udhëtojmë drejt Frankfurtit, mbërrijmë në orën 16:40. Marrim fluturimin për në Shanghai në orën 20:50.

Dita 2 : Mbërritja dhe mikpritja në Shanghai

Mbërritja në aeroportin e Shanghait . Më pas vijojmë me takimin e partnerëve tanë. Nisemi për në Shanghai me trenin Transrapid, i vetmi në llojin e tij në botë, i cili arrin shpejtësi mbi 300 km/h. Pas zbritjes nga treni, marrim autobusin dhe drejtohem për në hotel.

Bëjmë check-in në hotel. Pjesa tjetër e ditës e lirë.

Fjetja në **UrCove Shanghai Jing'an by HYATT**.

Vaktet e përfshira : Darka

Dita 3 : Shanghai

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin

Vizitë në Kopshtin Yu – një kopsht privat nga periudha e Dinastisë Ming me më shumë se 450 vite histori. Ky është një nga atraksionet më të famshme të qytetit të vjetër të Shangait.

Dreka në grup në një restorant kinez në qytet.

Vizitojmë Jade Buddha Temple. Tempulli quhet Tempulli i Budës prej Nefriti sepse strehon dy statuja të Budës prej nefriti të sjella nga Myanmari nga Mjeshtri Huigen i Malit Putuo. Njëra është një statujë e ulur e Sakyamuni-t dhe tjetra është një statujë e shtrirë e Sakyamuni-t.

Vizitojmë The Bund. I vendosur në bregun e lumit Huangpu në qendër të Shangait, the Bund është atraksioni më simbolik i Shangait.

Vizitojmë Nanjing Road, një nga rrugët më të famshme për këmbësorë në Kinë, gjithashtu rruga më e hershme tregtare e themeluar në Koncesionin Britanik në Shanghai.

Darka në grup në një restorant kinez në qytet.

Fjetja në **UrCove Shanghai Jing'an by HYATT**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 4 : Shanghai - Suzhou

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel.

Nisje me autobus drejt qytetit Suzhou (100 km)

Vizitë në Panmen – portë antike qyteti me tre pamje ikonike: Gupanmen, ura Wumen dhe Kulla Ruiguang. Është porta e vetme që përfshin akses tokësor dhe ujor.

Vizitë në fabrikën e mëndafshit – Suzhou është i famshëm për mëndafshin dhe kjo fabrikë tregon historinë dhe artin e punimit tradicional.

Dreka në grup në një restorant kinez në qytet.

Vizitë në kopshtin “Master of the Nets” – një nga shembujt më përfaqësues të kopshtarisë klasike kineze. Është pjesë e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Shëtitje në rrugën Pingjiang – në qytetin e vjetër të Suzhou-t, kjo zonë është vendtakim për banorët dhe plot me bare, dyqane dhe kënde çlodhjeje.

Darka në grup në një restorant kinez.

Fjetja në **UrCove Suzhou Shantang Street by HYATT**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 5 : Suzhou – Luzhi – Shanghai – Xi'an

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel.

Nisje me autobus drejt Luzhi-t (35 km)

Shëtitje me varkë në qytetin ujor – për të admiruar shtëpitë tradicionale dhe arkitekturën karakteristike kineze.

Vizitë në Tempullin Baosheng – tempull mbi 1500-vjeçar me një pemë ginko 50 metra të lartë dhe statuja të rralla të 9 Arhatëve të periudhës Tang.

Dreka në grup.

Nisje me autobus drejt aeroportit (60 km)

Fluturim drejt Xi'an me fluturimin 9C8947, darka ne bord.

Mbërritja në Xi'an dhe nisje drejt qytetit (40 km)

Akomodimi ne hotel.

Fjetja në **Mercure Xi'an Downtown Hotel**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Dreka

Dita 6 : Ushtria e Terrakotës dhe Tregjet e Xi'an-it

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel.

Nisje me autobus drejt Lintong (45 km)

Vizitë në Ushtrinë prej Terrakote – një nga zbulimet më të rëndësishme arkeologjike të

shekullit të 20-të, me mijëra statuja ushtarësh dhe kuajsh në madhësi natyrale.
Dreka në grup në një restorant në qytet.
Vizitë në një punishte punimi të nefritit – mjeshtëri e lashtë kineze ku gurët nefrit punohen në stoli dhe ornamente.
Kthim në Xi'an me autobus (45 km)
Vizitë në Qytetin e Vjetër – i njohur për ushqimet tradicionale dhe atmosferën kulturore.
Darka në grup në një restorant kinez.

Fjetja në **Mercure Xi'an Downtown Hotel**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 7 : Xi'an - Pekin : Zbulimi i Qytetit të Ndaluar

Zgjohehi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel.
Nisje për në stacionin e trenit (20 km)
Nisje me trenin e shpejtë G56 drejt Pekinit – një udhëtim prej rreth 4 orësh (1000 km)
Vizitë në Muzeun e Pallatit (Qyteti i Ndaluar) – kompleksi më i madh dhe më i ruajtur i ndërtesave antike në Kinë dhe në botë.
Darka në grup në një restorant kinez në Pekin.

Fjetja në **Mercure Beijing City Centre**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Darka

Dita 8 : Pekin – Muri i Madh Kinez dhe Pallati Veror

Mëngjesi në hotel (bufe mëngjesi)
Nisje me autobus drejt rrethit Changping (60 km)
Vizitë në një punishte perlash – një material i çmuar dhe shumë i dashur në kulturën kineze.
Vizitë në Murin e Madh të Kinës (sektori Juyongguan) – një nga tre pikat më të rëndësishme të Murit të Madh.
Dreka në grup në një restorant në qytet.
Kthim në Pekin (45 km)
Vizitë në Pallatin e Verës – resorti i perandreshës me liqenin Kunming dhe malin Wanshou. Është pjesë e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.
Darkë e lamtumirës në një restorant të njohur për rosën e pjekur në Pekin.

Fjetja në **Mercure Beijing City Centre**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka Speciale

Dita 9 : Pekin - Tiranë

Konsumojmë mëngjesin, bëjmë check-out herët në mëngjes dhe nisemi për në aeroport për tu kthyer në Tiranë.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi

DETAJE RRETH FLUTURIMIT :

Fluturimi Shqiperi – Kinë 23 Shtator 2025

Tirane (TIA) – Mynih (MUC) : 18:25 – 20:20

Mynih (MUC) – Shanghai (PVG) : 22:20 – 15:50 (24 Shtator)

Fluturimi Kinë – Shqiperi 01 Tetor 2025

Pekin (PEK) - Mynih (MUC) : 13:20 – 19:10

Mynih (MUC) – Tirane (TIA) : 21:45 – 23:30

Detajet e Turit

Ju lutem shikoni më poshtë të gjitha detajet e Turit

Përfshihen në çmim :

- Fluturimi Vajtje / Ardhje Tiranë – Shanghai - Tiranë
- 7 netë akomodim ne hotele me 4 * / 5*
- Mëngjesi, dreka & darka për pjesën më të madhe të ditëve (specifikisht te shenuara ne program)
- Fluturimi Shanghai - Xian
- Treni Bullet Xian – Beijing 2nd class
- Shërbimi i guidës lokale në anglisht
- Transferrat me autobus komod sipas programit
- Shoqërues nga Agjensia gjatë gjithë udhëtimit
- Biletat e hyrjeve në monumentet e përmendura në program

Nuk përfshihen në çmim :

- Vaktet të cilat nuk përmenden në program
- Shpenzime personale
- Cdo aktivitet qe nuk permendet ne rubriken “përfshihet”
- Bakshishe per shoferin dhe guidën (6 eur / person / ditë)